



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality Rahovec


Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

- III - Nr. I prot. 2495 Më 14.08.2019
Br. prot. Dt. 14.08.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORT I DËMEVE NË BUJQËSI 2019



Rahovec, korrik 2019

Përmbajtja

HYRJE.....	2
KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE	2
SEKTORËT E DËMTUAR.....	4
Sektori i vreshtarisë.....	4
Sektori i Perimekulturës dhe Lavërtarisë	5
Tabela nr. 1 Perimekultura -Lavërtari	5
Sektori i pemëtarisë	5
Tabela nr. 2 Pemëtaria	5
Tabela përmbledhëse për të gjithë sektorët.....	6
Tabela nr. 3 Tabela e përgjithshme.....	6
PËRFUNDIM.....	6

HYRJE

Komuna e Rahovecit që disa vite rresht pëson dëme të konsiderueshme nga moti i keq dhe kushtet e papërshtatshme klimatike. Edhe këtë vit fermerët e komunës sonë janë dëmtuar në masë të madhe.

Si pasojë e të reshurave të mëdha të breshërit dhe shiut, ky raport do të paraqes një përshkrim të dëmeve në kulturat bujqësore, në bazë të informacioneve të raportuara nga banorët e komunës së Rahovecit si dhe nga analiza e zyrtarëve që kanë dalë në terren.

Raporti përmban të dhëna të sakta nga vizita në terren, harta si dhe fotografi që e dëshmojnë dëmin e shkaktuar në kultura të ndryshme bujqësore që kultivohen në Komunën e Rahovecit.

Të gjitha këto të dhëna janë të nxjerra nga listat e përpiluara nga anëtarët e komisionit në terren gjatë vizitës në secilën parcelë që është prekur nga breshëri dhe vërshimet.

Janë përdorur dy metoda gjatë identifikimit të zonave të dëmtuara

1. Përkufizimi i zonës së breshrit, dhe nxjerrja e parcelave me të dhëna nga sistemi, dhe
2. Vizitë në secilën parcelë të përmbytur nga vërshimet

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE

Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës, nr. 01/236/19, i datës 19.06.2019, z. Smajl Latifi, është formuar komisioni vlerësues për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi nga breshëri dhe reshjet e rrëmbyeshëm të shiut gjatë ditëve 17,18 dhe 22 qershor dhe në vazhdim në komunën e Rahovecit, në përbërjen:

- | | |
|-------------------|----------|
| 1. Ilvi Durguti, | kryesues |
| 2. Jeton Kryeziu, | anëtar |
| 3. Veton Mustafa, | anëtar |

Komisionet vlerësuese, që nga data 18.06.2019 kanë dalë në terren, duke mbledhur informacione dhe mbajtur shënime se në cilat zona ka pasur dëme nga breshëri dhe përmbytje nga reshjet e rrëmbyeshëm të shiut.

Breshëri ka filluar në orët e pasdites së datës 17.06.2019 dhe ka zgjatur mbi 5-10 minuta në disa zona të komunës së Rahovecit, të cilat më pastaj janë shoqëruar me reshje të rrëmbyeshme duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në të gjitha kulturat bujqësore të cilat janë përfshirë nga kjo fatkeqësi natyrore.

Sipas vlerësimit të komisionit, sipërfaqet e tokave bujqësore të atakuara nga breshëri dhe vërshimet janë mbi 120 ha dhe ka përfshirë këto zona: Bërnjak, Potoqan i Epërm, Bellacërkë, Rahovec, Sopniq dhe Senoc.



Dëmet më të mëdha nga breshëri janë shkaktuar në zonat kadastrale si: Potoqan i Epërm, Rahovec, Senoc, Nashpall, dmth rrypi i breshrit ka kaluar rrëzë bjeshkës te Komunës së Rahovecit në zonat e lartcekura ku përqindja e demit të shkaktuar në këto zona ka qenë deri në 18-30% në disa kultura bujqësore.

Harta nr. 1, Epiqendra e zonës së goditur nga breshëri



Harta 1. Zona kadastrale: Potoqan i Epërm - Rahovec

Përveç dëmeve nga breshëri, reshjet e tepërta të shiut të cilat kanë vazhduar për disa ditë rresht, kanë shkaktuar dëme në zona si Bërnjak, Bellacerkë, Pataqan i Ulët dhe Sopniq. Shkaktar i këtyre dëmeve, ka bërë që rrjedha e ujit të dalë nga shtrati dhe kështu të shkaktoj dëme të konsiderueshme.

Harta e sipërfaqeve të vërshuara



Harta 2. Lokacioni të Kontrollimi teknik – Fortese



Harta 3. Dalja nga shtrati e lumit Duhlo – Bërnjak



Harta 3. Lokacioni Potoqan i Epërm



Harta 4. Lokacioni Fortese , Lumi Bellaja

Në pjesën kodrinore ka pasur gërryerje dhe bartje të dheut nga zonat e lartëcekura kadastrale, ndërsa në pjesët e ulëta kemi pasur përmytjet momentale të daljeve të lumenjve nga shtretërit për shkak të mos mundësisë së absorbimit të sasisë të ujërave momental që kanë gravituar.

Dëmet më të mëdha nga vërshimet kanë ndodhur në zonën kadastrale Bërnjak, Bellacerkë dhe Sapniq.

SEKTORËT E DËMTUAR

Kushtet klimatike të mesit të muajit qershor 2019, ishin të atilla që shkaktuan dëme pothuajse në të gjithë sektorët e bujqësisë në Komunë të Rahovecit.

Nga breshëri dhe vërshimet janë dëmtuar shumë sektorë të cilët do të grupohen në 4 grupe:

1. Sektori i vreshtarisë,
2. Sektori i lavërtarisë dhe
3. Sektori i perimekulturës
4. Sektori i pemëtarisë

Sektori i vreshtarisë

Në sektorin e vreshtarisë janë të dëmtuara sipërfaqe prej 106.18 ha. Shkalla e breshrit ka përfshirë zonën në mes të fshatit Pataqan i Epërm dhe qytetit të Rahovecit, ku dëmet janë në masën prej 25-30%. Po ashtu edhe pjesën e Senocit dhe Nashpallës ku shkalla e dëmit është rreth 18-22%.

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar në Ha
1	Rrush	106,18

Sektori i Perimekulturës dhe Lavërtarisë

Vet fakti se Rahoveci njihet edhe si kryeqyteti i bujqësisë kjo dëshmohet edhe nga sipërfaqet me kultura perimtare.

Nga të dhënat e grumbulluara të anëtarëve të komisionit llogaritet se nga vërshimet dhe një pjese nga breshëri janë përfshirë **23.02 ha**, ku dominon kultura e qepës me 5.85 ha dhe specit me 5.22 e duke vazhduar me shalqi, domate, patate, pjepër etj.

Tabela nr. 1 Perimekultura -Lavërtari

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar në Ha
1	Specia	5.22
2	Shalqi	3.24
3	Patate	2.93
4	Domate	1.26
5	Qepë	5.85
6	Lakra	0.10
7	Hudhër	0.29
8	Lulelakër	0.55
9	Kunguj	0.75
10	Pjepër	2.00
11	Tranguj	0.08
12	Tërshërë	1.38
13	Fasule	0.03
14	Preshi	0.15
15	Grurë	0.50
16	Misër	0.69
TOTAL		25.02

Sektori i pemëtarisë

Fakti që komuna jonë dominohet nga perimet dhe vreshtat, pemëtaria shtrihet në masë më të vogël dhe si rezultat i kësaj edhe sipërfaqet e dëmtuara janë minimale.

Tabela nr. 2 Pemëtaria

Nr.	Lloji i kulturës pemëtare	Sipërfaqe e dëmtuar në ha
1	Kumbull	1.76
2	Dredhëza	1.15
TOTAL		2.91

Tabela përmbledhëse për të gjithë sektorët

Sqarim: Në tabelën e mëposhtme janë kategorizuar dëmet e përgjithshme në perimekulturë, lavërtari, vreshtari dhe pemëtari.

Tabela nr. 3 Tabela e përgjithshme

Nr.	Kultura	Vlera në €
1	Perimekulturë	139,188.09 €
2	Lavërtari	5,960.84 €
3	Vreshtari	119,718.10 €
4	Pemëtari	7,876.00 €
TOTAL		272,743.03 €

PËRFUNDIM

Raporti është përgatitur me kujdes, falë një punë të mundimshme e cila i ka marrë kohë komisionit për vlerësimin e dëmeve. Komisioni ka dalë në terren ku ka parë, analizuar dhe ka bërë vlerësimin.

DBPZHR ka grumbulluar fotografitë dhe videot si dëshmi që i ruan për të faktuar dëmet e mëdha.

Shkalla e gabimit në gjithë këtë proces të vlerësimit dhe kalkulimit të të dhënave është 3%.

Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve në bujqësi përmban edhe listën e bujqve të dëmtuar, emrat dhe mbiemrat e tyre, sipërfaqet e dëmtuara, sasinë e përlogaritur në kg. si dhe vlerën financiare të dëmit.

Komisioni vlerësues:

1. Ilvi Durguti,

2. Jeton Kryeziu,

3. Veton Mustafa,